



QENDRA
E PROVIMEVE

SHIFRA
E NXËNËSIT


PROVIMI I MATURËS DHE
PROVIMI PROFESIONAL

QERSHOR, 2024

**GJUHË SHQIPE
DHE LETËRSI**



* A 1 2 9 1 5 5 4 *



ME RËNDËSI!

“KANDIDATI HUMB TË DREJTËN E PROVIMIT, NË ATË AFAT TË PROVIMIT, KUR GJATË PROVIMIT, PËRKATËSISHT VLERËSIMIT, VËRTETOHET SE KA PËRDORUR MJETE TË PALEJUARA, SE KA KOPJUAR DETYRËN E DIKUJT TJETËR OSE SE DETYRËN E VET IA KA DHËNË NXËNËSIT TJETËR.”

(Rregullorja për mënyrën, procedurën dhe kohën e dhënies së Provimit të Maturës në gjimnaz, neni 24; Rregullorja për mënyrën dhe procedurën e dhënies së Provimit Profesional për nxënësit të cilët vazhdojnë arsimimin, neni 27)



UDHËZIM

KOHA PËR ZGJIDHJE TË TESTIT ËSHTË 180 MINUTA

Gjatë testit nuk lejohet përdorimi i mjeteve elektronike.

Nxënësi/nxënësja nuk guxon në asnjë mënyrë ta zbulojë identitetin e vet në test ose t'i drejtohet vlerësuesit në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Testi DUHET të shkruhet LEXUESHËM me laps kimik. Nxënësi/nxënësja mund të shkruaj me shkronja dore ose shtypi. Nëse shkruan me shkronja shtypi DUHET të theksojë shkronjën e madhe.

Testi përmban detyra të cilat zgjidhen në njërën prej mënyrave në vazhdim:

- duke rrethuar numrin para përgjigjes së saktë
- duke shkruar një përgjigje të shkurtër
- duke shkruar një përgjigje më të gjatë
- duke shkruar një tekst funksional
- duke shkruar ese

Me testin ke marrë edhe **fletën e përgjigjeve** për detyrat me zgjedhje të shumëfishtë.

Nevojitet që në vendin përkatës me kujdes të përshkruash përgjigjet tua.

Detyra do të vlerësohet me zero pikë nëse:

- është e pasaktë
- përgjigjja në detyrë me zgjedhje të shumëfishtë **NUK** është bart në fletën e përgjigjeve
- është rrethuar ose shkruar edhe përgjigjja e saktë dhe e pasaktë
- përgjigjja/eseja është e palexueshme dhe e paqartë
- përgjigjja/teksti funksional/eseja është shkruar me laps të thjeshtë
- teksti funksional/eseja **NUK** është shkruar në vendin e paraparë, por vetëm në faqet e parapara për koncept (shkrimi i konceptit nuk është i detyrueshëm)

Nëse gabon, vendos një vijë të kryqëzuar mbi të dhe detyrën zgjidhe përsëri. Kur ta përfundosh punën, kontrolloji edhe njëherë përgjigjet tua.

Me fat!

Lexo fragmentin, pastaj zhvillo detyrat 1, 2, 3, 4 dhe 5.

Energjia bërthamore është energjia e çliruar gjatë copëtimit ose shkrirjes së bërthamave atomike. Sasitë e energjisë që mund të merren përmes proceseve bërthamore tejkalojnë shumë ato që mund të merren përmes proceseve kimike, të cilat përdorin vetëm rajonet e jashtme të atomit.

Disa izotope të elementeve të caktuara kanë aftësinë, përmes reaksioneve bërthamore, të lëshojnë energji gjatë procesit. Bazohet në parimin që një transformim i masës në energji ndodh në reaksionet bërthamore. Një reaksion bërthamor është modifikimi i përbërjes së bërthamës atomike të një elementi që mund të shndërrohet në elemente të tjerë. Ky proces ndodh spontanisht në disa elemente; në të tjerët, reagimi duhet të provokohet me anë të bombardimit të neutroneve ose teknikave të tjera. Ekzistojnë dy mënyra për të shfrytëzuar energjinë bërthamore për ta shndërruar atë në nxehtësi: Ndarja bërthamore, ku bërthama atomike ndahet në dy ose më shumë shkrirje bërthamore, në të cilën të paktën dy bërthama atomike bashkohen për të prodhuar një bërthamë të re.

Përparësia kryesore e energjisë bërthamore e marrë nga copëtimi është se ajo nuk përdor lëndë djegëse fosile, nuk lëshon gazra toksikë në atmosferë dhe nuk është përgjegjëse për rritjen e efektit serë.

Përdorimi i energjisë bërthamore po rritet çdo ditë. Energjia bërthamore është një nga alternativat më pak ndotëse, ju lejon të fitoni shumë energji në një hapësirë të vogël dhe instalimet e impianteve afër qendrave të konsumatorit, duke ulur koston e shpërndarjes së energjisë. Energjia bërthamore bëhet një mundësi më shumë për të përmbushur në mënyrë efektive kërkesën për energji në botën moderne. Ndarja bërthamore e uraniumit është aplikimi kryesor civil i energjisë bërthamore. Përdoret në qindra termocentrale bërthamore në të gjithë botën, kryesisht në vende si Franca, Japonia, Shtetet e Bashkuara, Gjermania, Suedia, Spanja, Kina, Rusia, Koreja e Veriut, India Pakistan, ndër të tjera.

Vendet evropiane janë ato që përdorin më shumë energjinë bërthamore. Duke marrë parasysh prodhimin e përgjithshëm të energjisë elektrike në botë, pjesa e energjisë bërthamore u rrit nga 0,1% në 17% në 30 vjet, duke e sjellë atë afër përqindjes së prodhuar nga hidrocentralet. Sipas Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (IAEA) në fund të vitit 1998 kishte 434 termocentrale bërthamore në 32 vende dhe 36 njësi po ndërtoheshin në 15 vende. Vendimi për të ndërtuar impiante varet kryesisht nga kostot e prodhimit të energjisë bërthamore.

Fatkeqësitë bërthamore

- **Çernobil:** Më 26 Prill 1986, një eksperiment i kryer dobët, i kombinuar me probleme strukturore në impiant dhe faktorë të tjerë, bëri që reaktori i katërt në Çernobil të shpërthente. Rreth 31 njerëz vdiqën në shpërthim dhe gjatë

shuarjes së zjarrit. Qindra të tjerë vdiqën më vonë nga ekspozimi akut ndaj radioaktivitetit, në një shkallë 400 herë më të madhe se ajo e bombës në Hiroshima.

- **Bomba bërthamore:** Një bombë atomike është një armë shpërthyes, energjia e së cilës buron nga një reaksion bërthamor dhe ka një fuqi të madhe shkatërruese. Një bombë e vetme është e aftë të shkatërrojë një qytet të tërë. Bombat atomike u përdorën vetëm dy herë në luftë, nga Shtetet e Bashkuara kundër Japonisë në qytetet Hiroshima dhe Nagasaki, gjatë Luftës së Dytë Botërore. Sidoqoftë, ato janë përdorur qindra herë në provat bërthamore nga disa vende.

- **Centrali Bërthamor (SHBA):** Fabrika bërthamore Three Mile Island në Pensilvani rrezikon të shkrihet, lloji më i rëndë i aksidentit bërthamor. Kërcënimi vjen nga një flluskë avulli brenda reaktorit, e cila mund të rritet në madhësi ndërsa presionet e brendshme relaksohen, duke e lënë bërthamën pa ujin jetik për ftohjen e tij.

Burimi: <https://sq.e-reve.com/energia-nuclear-1863>

1. Për çfarë dukurie flet ky tekst?

1 pikë	
--------	--

2. Qëllimi i tekstit të dhënë është:

1. udhëzimi
2. përshkrimi
3. informimi

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë	
--------	--

3. Gjej dhe shkruaj informacionin e ri që jepet në paragrafin e tretë.

1 pikë	
--------	--

4. Cila është mënyra që e pakëson koston e shpërndarjes së energjisë?

1 pikë	
--------	--

5. Cilat janë përfitimet dhe pasojat energjisë bërthamore?

2 pikë	
--------	--

Lexo fragmentin, pastaj zhvillo detyrat 6, 7, 8 dhe 9.

Kryetari nisi ta pyesë duke e shikuar në sy me një armiqësi të thatë. "Zot, - i tha, -për ç' qëllim keni ardhur në Shqipëri? " -Se jam shqiptar dhe desha të vizitoj vendin tim". - Kush jua heq harxhet e udhës? Asnjëri " Halld ettin! Po s'e paguajtin, çan kokën të udhëtojnë njeriu?" Dhe fytyra e kryetarit të policisë u ngrys më tepër. Dëgjoni,- tha doktori. - Jam i pasur, pse të mos e bëj një udhëtim për të çlodhur mendjen dhe për të kënaqur shpirtin tim?" Posa dëgjoji për pasuri, fytyra e komisarit u but menjëherë dhe nënqeshi. Nxori një kuti cigaresh dhe ia zgjati mjekut. " Zoti doktor, - tha komisar, - mos i merrni për keq pyetjet e mia. Janë formalitete pa rëndësi, po kam detyrë t'i mbaroj." Pastaj iu kthye policit që kish prurë doktor Gjilpërën dhe i tha të porositi dy kafe të mira. Kur doli polici jashtë, komisar i ofroi fronin pranë doktorit.

" Zoti doktor, - më dukeni njeri i mirë dhe ju nderoj me të vërtetë. Le të flasim shkoqur. S' vjen njeri për qejf në Shqipëri, kur mund të shkojë kohën e tij në kafeshantanet me famë të Evropës. Ç'interes ju pruri në këtë vend të mallkuar?" Dr. Gjilpëra kish nisur të shohë në thellësiat e errëta të këtij shpirti barbar , dhe kuptoi se do ish kohë e humbur t'i jepte shpjegime të kthiellëta.

(...)

Qëndroni pak, nënqeshi dhe vazhdoi duke ulur zërin e duke shikuar Gjilpërën në sy; " Zoti doktor, kam grua e fëmijë , dhe s' janë mirë nga shëndeti. Kini mëshirë të më falni ca ilaçe?" Dr. Gjilpëra e shikoi në sy dhe e kuptoi qëllimin e këtij barbari të korruptuar."

("Doktor Gjilpëra", Faik Konica)

6. Shkruaj llojin e romanit që i përket fragmenti i dhënë.

1 pikë	
--------	--

7. Komisar i policisë sipas gjuhës që përdor në fragment mund të karakterizohet:

1. hipokrit dhe servil
2. përçmues dhe arrogant
3. vlerësues dhe i dashur

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë	
--------	--

8. Çfarë nënkupton titulli simbolik "Doktor Gjilpëra"?

2 pikë	
--------	--

9. Cilat janë deformimet shoqërore që zbulon personazhi kryesor në shoqërinë shqiptare të kohës?

1 pikë	
--------	--

Lexo fragmentin në vazhdim dhe zhvillo detyrën 10.

- U shitne a s'u shitne flamujt, qëndroi a s'qëndroi Shqipnija, un kam mjaft, shyqyr, me jetue: a more vesht? E tash, jashtë...

- Kadalë... ia priti djaloshi me t'egër e sytë i vetuen: - dal vetë, s'ashtë nevoja me më qitë jashtë ti. Por edhe një fjalë due me t'a thanë e të lutem vire ne vesh si at këshillë qi më dhae par në dugajë. Ti thue se jeton, por rrelesh. Ti je shlye prej numrit të të gjallëve qyshse je ndry në kët dugajë mbushë me mall. Ky asht vorri i yt. E sa për Shqipni po të siguroj un se ka me qindrue. Prandej mos ban merak se edhe flamujt kanë me t'u shitë krejt. Por rueje shpirtin t'and mos t'ia shtish dreqit.

10. Si rrjedhojë e kujt ndodh kundërvënia në mes të dy personazheve?

1 pikë	
--------	--

11. Lexo me kujdes dhe përshkruaj vetëm veçorinë që nuk i takon letërsisë moderne shqipe?

përdorimi i vargut të lirë

strukturat e reja stilistike

gjuha e re poetike

forcimi i identitetit kombëtar

depërtime të thella psikologjike

1 pikë	
--------	--

Lexo vargjet dhe zhvillo detyrat 12, 13 dhe 14.

Mjerimi punon, punon dit e natë
Tu' i vlue djersa në gjoks edhe në ballë,
Tue u zhigatun deri në gjuhë në baltë
E prap zorrët nga uja i bahen palë-palë.
Shpërblim qesharak! Për qindenjë afsh
Në ditë- vetëm: lekë tre-katër edhe "marsh!"
(...)
Mjerimi s'ka gëzim, por ka vetëm dhimba,
Dhimba paduruese që të bajnë të çmendesh,
Që t'apin litarin të shkojsh fill e të varesh,
Ose bahe fli e mjerë paragrafesh

12. Ligjërimi poetik me të cilin janë ndërtuar vargjet e dhëna shprehet me:

1. revoltë
2. shqetësim
3. konstatim

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë	
--------	--

13. Cilat figura stilistike përdoren në fjalët e nënvizuara?

Mjerimi, punon, punon dit e natë
Shpërblim qesharak!

2 pikë	
--------	--

14. A) Cili nga vargjet e dhëna më poshtë përshkruan portretin shpirtëror të mjerimit?

1. Dhimba paduruese që të bajnë të çmendesh
2. Mjerimi punon, punon dit e natë
3. Në ditë-vetëm: lekë tre/katër edhe "marsh!"

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë	
--------	--

B) Argumentoje përgjigjen.

1 pikë	
--------	--

15. Shpjego qëllimin e autorit (Tolstoit) në veprën Ana Karanina, i cili nuk gjykon as Anën dhe as Levinin, pavarësisht zgjedhjeve të tyre.

2 pikë	
--------	--

Lexo fragmentin nga *Koprraci* (Molieri) pastaj puno detyrat 16 dhe 17.

Harpagoni- Që të më vijë mendja, duhet të shoh më parë arkën time.

Kleanti- Do ta shohësh që është shëndosh e mirë dhe krejt e paprekur.

Harpagoni- S' kam asnjë dysh për martesën e fëmijëve të mi.

Anselmi- Mirë, pra! Kam unë për ata, mos u shqetësoni për këtë.

Harpagoni- Do t'i merrni përsipër të gjitha shpenzimet e të dy martesave?

Anselmi- Po, i marr. A jeni i kënaqur?

Harpagoni- Po, në qoftë se më bëni edhe një palë rroba të reja për dasmë.

Anselmi- Ju bëj edhe një palë rroba. Le të vemë të shijojmë gëzimin e madh që na fali kjo ditë e lumtur.

Komisari- Ej, zotërinj, pa dale, ju lutem; kush do të më paguajë shkresat dhe mundimin tim?

Harpagoni- Nuk na hyjnë në punë shkresat tani.

Komisari- Mirë, po unë s'i bëra për shpirt të babait...

Harpagoni- (Duke treguar Usta Jakun) Ja, si shpërblim, merreni këtë dhe vareni.

Usta Jaku- O Zot! S'di nga t'ia mbaj i ziu njeri! Kur thashë të vërtetën, hëngra dru, tani që gënjeva, duan të më varin.

16. A) Rretho numrin para llojit të komedisë nga cila është shkëputur ky fragment.

1. komedi sociale
2. komedi morali
3. komedi karakteri

1 pikë

B) Argumentoje përgjigjen.

1 pikë

17. A) Në çfarë forme zhvillohet dialogu në mes personazheve të komedisë?

1 pikë

B) Argumentoje përgjigjen.

1 pikë

18. Në poemat homerike përgjatë rrëfimit janë përdorur të ashtuquajturat "teknika homerike". Veço (përshtroje) teknikën e cila nuk u përket këtyre teknikave.

kronologjia pararendja retrospektiva rimarrja

1 pikë

19. Shpjego përdorimin e dy pikave në fjalinë:

Kishin ide të ndryshme: disa donin të organizoheshin në grupe më të vogla, disa donin të gjithë në një sallë.

1 pikë

20. Shkruaj llojin e fjalisë së nënvizuar:

Nuk dua më të vijë këtu, larg qoftë, të punojë me ne.

1 pikë	
--------	--

21. Veço (përshkruaji) fjalët e shkruara saktë.

pikësëpari pikë së pari afër mendsh afërmendsh i patëmetë i pa të metë

1 pikë	
--------	--

22. A) Folja jetoj në fjalinë: "Kishte jetuar jetën që kishte dashur." është folje:

1 pikë	
--------	--

B) Argumentoje përgjigjen.

1 pikë	
--------	--

23. Përcaktoni klasën e fjalëve të nënvizuara në fjalinë:

Ai është nga ata njerëz që mendojnë shumë dhe përpiqen t'i futen thellë kuptimit të çdo dukurie që ndodh në jetën e tyre. Por sa më tepër që mendojnë njerëzit, aq më të palumtur ndihen.

1. nga: _____

2. thellë: _____

3. e tyre: _____

4. të palumtur _____

2 pikë	
--------	--

25. Janë dhënë dy tema për hartimin e esesë. Rretho numrin para temës të cilën e ke zgjedhur dhe shkruaje esenë që duhet të ketë nga 250 deri në 300 fjalë.

• **Me rastin e zhvillimit të temës, shfrytëzo shembujt relevant/të dhënat dhe argumento qëndrimet personale.**

• Respekto kërkesën për numrin e fjalëve +/-10% (vlerësohet punimi që ka 225 deri në 330 fjalë; nëse eseja ka më pak se 225 fjalë NUK LEXOHEM FARE, kurse në fjalën e 330-të NDËRPRITET leximi). Eseja DUHET të shkruhet në fletët e parapara për shkrimin e esesë (eseja e shkruar në fletët e konceptit NUK LEXOHEM).

• **Bëj kujdes për saktësinë gjuhësore dhe që teksti të jetë i lexueshëm.**

1. Ema Bovari, në mes ëndrrës dhe zhgënjimit - Gustav Fober

UDHËZIME PËR SHKRIMIN E ESESË:

- Shkruaj tiparet themelore të veprës (titullin, autorin, formën letrare, drejtimin letrar)
- Portretizo Emën, marrëdhënien bashkëshortore me Sharlin. Përse lind një kundërvënie e tillë në mes tyre? Jepe mendimin tënd.
- Shkruaj nëse ekziston një kufi që njeriu u vë ëndrrave të veta. Pse?

Fragment nga vepra

Megjithatë, ajo nganjëherë mendonte se ato ditë të para të martesës ishin më të bukurat e jetës së saj, muaji i mjaltit, siç thuhet. Që ta shijonte nektarin e tyre, e mira ishte të kalonte nëpër ato vende me emra kumbues, ku ditët e para pas martesës kalohen në një plogështi aq të këndshme! Hipur në ndonjë karrocë poste, me perde mëndafshi të kaltër nga brenda, ngjitesh ngadalë nëpër rrugët e rrëpirëta, duke dëgjuar gurgullimën e shurdhët të ujëvarës. Kur perëndon dielli, ngopesh me erën e këndshme të limonëve në breg të gjirëve të detit; pastaj në mbrëmje, duke ndenjmur mbi tarracën e vilave, vetëm për vetëm dhe kapur dorë për dorë, vështron yjet dhe bën plane për të ardhmen. Ajo mendonte se në këtë rruzull tokësor disa vende duhet të krijonin lumturi, si ndonjë bimë e veçantë, që çel mbarë në një vend dhe që s'bëhet dot askund tjetër. Përse të mos prehej edhe ajo, mbështetur mbi bërryla në ballkonin e ndonjë vile zvicerane, a të mbyllej bashkë me trishtimin e saj në ndonjë shtëpizë fusharake skoceze, si bashkëshorte e një burri të veshur me frak kadifeje të zeze me kinda të gjatë dhe me çizme prej lëkure të butë, me kapelë me majë dhe me mansheta!

Ndoshta do të kishte dëshirë t'ia hapte zemrën ndokujt për të gjitha këto ëndërrime. Po si mund ta shprehte një siklet të pakapshëm, që ndërronte trajtë si retë, që vërtitej si vorbull ere? Nuk gjente dot fjalët, domethënë rastin, i mungonte guximi.

Megjithatë, asaj i dukej se, po ta donte Sharli një gjë të tillë, po ta kishte parandier, po të ishte puqur qoftë edhe një herë të vetme shikimi i tij me mendimet e saj, zemra do t'i zbrazej përnjëherë nga gjithë ajo ngarkesë, ashtu siç bien frutat e pjekura të pemëve sa vë dorën në to. Mirëpo, sa më shumë i lidhte jeta bashkëshortore, aq më tepër në brendësi të shpirtit ajo shkëputej prej tij.

Bisedat që bënte Sharli ishin të rrafshëta si trotuare rrugësh dhe në to qarkullonin mendime dosido të njerëzve me veshje aq të zakonshme, sa s'të ngjallnin asnjë emocion, s'të bënin as të qeshje, as të ëndërroje. Kur banonte në Ruan, i thoshte ai, s'ishte bërë asnjëherë kureshtar të shkonte të shihte ndonjë shfaqje në teatër me aktorë nga Parisi. S'dinte as të notonte, as të bënte skermë, as të gjuante me pisqollë, bile, një ditë, nuk kishte qenë në gjendje t'i shpjegonte asaj një term të të hipurit në kalë, të cilin ajo e kishte hasur në një roman.

Mirëpo, a nuk është e domosdoshme vallë që burri të shkëlqejë në shumë drejtime, ta bëjë bashkëshorten të njohë forcën e pashtershme të dashurisë, shijet e stërholluara të jetës, të gjitha të fshehtat? Ndërsa ai s'i mësonte asaj asgjë, s'dinte kurrëgjë, s'kishte asnjë dëshirë. Kujtonte se ajo ishte e lumtur; dhe ajo e kishte inat që ai s'e prishte fare terezinë, që s'dilte kurrë nga ajo plogështi e patrazuar, që e ndiente bile veten të lumtur prej saj.

(fragment nga "Zonja Bovari", Gustav Flober)

2. Të studiosh brenda apo jashtë vendit?

UDHËZIME PËR SHKRIMIN E ESESË:

- Pse janë të rëndësishme studimet? Shkruaj rrethanat, kushtet, arsyet që përcaktojnë vazhdimin apo jo të studimeve.
- Krahaso vendin tënd me një vend të huaj duke paraqitur avantazhet dhe disavantazhet e njërit dhe tjetrit sa i përket studimeve.
- Sa është i suksesshëm punësimi në vendin tonë pas përfundimit të studimeve.

13 pikë	
---------	--

